Brenda tre muajve nga mbyllja e cdo viti financiar drejtoria I paraqet atij me qellim verifikimi dhe kontrolli , llogarite vjetore , si dhe nje raport te shkruar per gjendjen e shoqerise dhe aktivitetet e saj gjate vitit financiar te mbyllur.

Keshilli mbikqyres I paraqet asamblese se aksionereve komentet e tij mbi raportin vjetor te nxjerre nga drejtoria ne perputhje me nenin 130 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

## KREU VI
## DREJTORIA / BORDI DREJTUES

### Neni 21
### Drejtoria

1- Shoqeria drejtohet nga nje drejtori e perbere nga nje drejtor. Drejtori mund edhe te mos jete aksioner. Drejtori nuk mund te jete anetar I Keshillit Mbikqyres.

2- Drejtori emerohet per nje afat tre vjetesh me te drejte rizgjedhjeje

3- Drejtori eshte perfaqesues ligjor I shoqerise. Drejtor I shoqerise eshte Z. **Mirel Mertiri.**

4- Keshilli mbikqyres cakton masen e shperblimit per drejtorin ne momentin e emerimit.

5- Drejtori mund te shkarkohet nga keshilli mbikqyres ne cdo kohe per arsye te perligjura te parashikuara ne nenin 98 te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare".

6- Ne rast se posti I drejtorit mbetet bosh per shkak vdekjeje, doreheqjeje, shkarkimi, paaftesie ne pune, te nje prej anetareve te tij apo cdo shkaku tjeter, pasardhesi qe do te plotesoje vendin do te zgjidhet nga keshilli mbikqyres ne mbledhjen e pare qe ndjek lenien bosh te vendit. Drejtori I zgjedhur ne kete menyre do te qendroje ne detyre per te gjithe kohen e mbetur te mandatit te paraardhesit te tij.

### Neni 22

### Mbledhja e drejtorise

- Drejtori therret mbledhjen e drejtorise, nese ajo ekziston, duke percaktuar rendin e dites, ne cdo kohe qe e quan te nevojshme apo ne rast se ai merr kerkese me shkrim nga te pakten1/3 (nje e treta) e anetareve te drejtorise. Kerkesa duhet te permbaje listen e ceshtjeve apo temave qe duhen diskutuar. Ne rast se drejtori refuzon te therrase mbledhjen brenda 5 ( pese) diteve nga marrja e kerkeses , mbledhja mund te thirret nga kerkuesit. Drejtoria do te thirret me ane te nje letre rekomande, telegrami ose faksi, ose e-mail te derguar te pakten tre dite perpara mbledhjes. Ne raste urgjente mbledhja mund te thirret telegrami ose faksi, ose e-mail te derguar nje dite perpara dites se caktuar te mbledhjes. Ne rast se drejtori mungon per ndonje arsye, nuk ka mundesi te marre pjese ne mbledhje, te gjitha funksionet e percaktuara ne kete nen I kalojne zevendes drejtorit nese ka ose drejtorit me te vjeter ne detyre. Drejtoria do te mblidhet ne menyre te vlefshme edhe nese nuk eshte bere njoftimi formal I thirrjes me kusht qe te gjithe drejtoret te jene te pranishem dhe te informua per rendin e dites qe do te diskutohet.

- Mbledhja e Drejtorise do te mbahet te pakten nje here ne tre muaj ne seline e shoqerise ose ne ndonje vend tjeter ne Shqiperi apo jashte, dhe mund te zhvillohen edhe telekonferenca ose videokonferenca ose me ane te mjeteve te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjithe pjesemarresit te identifikohen dhe tu jepet mundesia te ndjekin diskutimet dhe te marrin pjese aktive ne to. Nese ekzistojne keto kushte drejtoria quhet e mbledhur ne vendin ku ndodhet drejtori dhe sekretari I mbledhjes, me qellim qe te mbajne procesverbalin dhe ti firmosin ato.

- Mbledhjet e drejtorise quhen te mbledhura ne menyre te vlefshme kur jane te pranishem shumica e drejtoreve nese ka. Vendimet e drejtorise jane te vlefshme kur

miratohen me voten pro te shumices se anetareve te drejtorise te pranishem.Ne rast votash te barabarta vota e drejtorit eshte vendimtare.

**Neni 23**
**Kompetencat e drejtorise**

Drejtoria ka kopetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise, por kufizohet nga ato kopetenca qe ligji ua ka dhene shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe asamblese se aksionereve.

Drejtoria I ushtron kopetencat e veta brenda objektit te shoqerise.

Ne mardheniet me te tretet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorise edhe kur keto akte nuk kane te bejne me objektin e shoqerise pervec kur provon se te tretet e dinin apo duhet ta dinin se keto akte ishin jashte objektit te shoqerise.

Merr masat te rregullit te brendeshem qe nuk u kundevihen te treteve. Per perfundimin e operacioneve te renditura me poshte drejtoria vepron me autorizim paraprak te Keshillit Mbikqyres.

a.Dhenia e dorezanive dhe garancive

b.Kryerja e investimeve tej atyre te parashikuara ne programin financiar vjetor

c.Hapja e veprimtarise ose degeve te reja,shkrirja bashkimi dhe mbyllja teresisht ose pjeserisht e veprimtarive dhe degeve te shoqerise.

d.Pjesmarrja ne shoqeri te tjera te krijuara ose per te krijuar

e.Shitja dhe shkembimi I pasurive qe perbejne aktive te qendrueshme te shoqerise

f.Negocimi, perfundimi a ndryshimi I cdo kontrate me afat ose per nje shume mbi kufijte e percaktuar cdo vit nga keshilli mbikqyres.

Kur nje operacion kerkon autorizimin e Keshillit Mbikqyres dhe ky I fundit e refuzon kete, drejtoria mund te therrase asamblene e pergjithshme dhe I parashtron asaj ceshtjen.Asambleja e pergjithshme vendos per kryerjen ose jo te operacionit.

**Neni 24**
**Bordi drejtues**

Drejtoria mund te emeroje nje Bord Drejtues, te cilit mund t'I kerkoje nje mendim, I cili nuk ka fuqi detyruese mbi disa ceshtje te rendesise se vecante ne drejtimin e aktivitetit te shoqerise.

Bordi Drejtues do te perbehet nga 7 anetare te zgjedhur ndermjet personave me moral dhe prestigj te padiskutueshem. Nuk do te kete mosperputhje te detyres mes anetarit te Bordit Drejtues dhe nje funksionari tjeter ne shoqeri.

Anetaret e Bordit Drejtues qendrojne ne detyre per 2 (dy) vjet dhe mund te rizgjidhen.

## KREU VII
## KONTABILITETI/ VITI FINANCIAR/ BILANCI VJETOR

**Neni 25**
**Kontrolli kontabel**

Kontrolli kontabel I brendshem I shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel te autorizuar, te emeruar per nje vit financiar.

Eksperti kontabel emerohet nga Asambleja e Zakonshme.

Ne baze te nenit 93 te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare", ekspert kontabel I pare emerohet **z. Myzafer Gura**

**Neni 26**
**Viti financiar/ Inventari/ Bilanci**

Viti financiar fillon ne date 1 janar dhe mbyllet ne date 31 dhjetor te cdo viti.

Drejtoria mban nje rregjister te rregullt te pasurise dhe te aktivitetit te tij ne perputhje me ligjin. Ne fund te vitit financiar, Drejtoria harton dhe bilancin vjetor per ate vit financiar.

**Neni 27**
**Rezultati I vitit financiar/ Percaktimi I fitimit**

Drejtoria harton bilancin vjetor ne perputhje me ligjin. 5 % e fitimit neto qe rezulton nga bilanci I miratuar ne baze te dispozitave te ligjit te mbahet per rezerven kryesore deri sa kjo rezerve te arrije 10 % te kapitalit te shoqerise.

Megjithkete ,pas heqjes se shumave per t'u kaluar ne rezerve ne zbatim te ligjit, asambleja e pergjithshme, mund te heqe cdo shume qe ajo e gjykon te pershtatshme per te krijuar rezerva te zakonshme ose te jashtezakonshme ose per ta mbartur shumen ne ushtrimin e ardhshem.

Fitimi I mbetur shperndahet ndermjet aksionereve ne perputhje me numrin e aksioneve qe I perkasin secilit ose shperndahet ne baze te vendimeve te asamblese se aksionereve per shperndarjen e dividenteve apo zerave te tjere.

**Neni 28**
**Likuidimi/ Mbyllja**

Perjashtuar rastin e nje prishje me vendim gjyqi te parashikuar nga ligji shoqeria mund te prishet me mbarim te afatit te caktuar me statut ose me vendim te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve.

Pervec rastit te bashkimit ose te ndarjes prishja e shoqerise per cfardo shkaku qofte sjell likujdimin e saj. Likujdimi kryhet nga nje ose disa likujdatore te emeruar nga asambleja e pergjithshme e zakonshme ose nga asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme ne kushtet e quorumit dhe te shumices per asamblete e zakonshme.

Likjdatori perfaqson shoqerine. Ai ka kompetenca te plota per te shitur aktivet e shoqerise, per te shlyer kreditoret dhe per te shperndare mbetjen e disponueshme.

Asambleja pergjithshme e aksionereve mund te autorizoje likujdatorin te vazhdoje ceshtjet ne proces ose te ndermarre ceshtje te reja per nevojat e likujdimit.

Aktivi neto I mbetur, pas shlyerjes te vlerse nominale te aksioneve ndahet midis aksionerve ne perpjestim me pjesmarrjen e tyre ne kapital.

**Neni 29**
**Publikimet**

Me qellim qe te kryhen publikimet lidhur me themelimin e shoqerise te gjitha kompetencat I jepen Z. Mirel Mertiri, I cili eshte dhe Drejtor I kesaj shoqerie., I cili ka te drejte te :

-firmos dhe ben te publikohet njoftimi I themelimit ne nje gazete te autorizuar per njoftimet ligjore.

-kryen te gjitha formalitetet per rregjistrimin e shoqerise ne rregjistrin tregtar

-dhe pergjithsisht per te kryer te gjitha formalitetet e kerkuara nga ligji.

## KREU VIII

## DISPOZITA PERFUNDIMTARE

### Neni 30
### Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likujdimit te saj midis shoqerise dhe aksionereve ose midis vete aksionereve,lidhur me veprimtarine e shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejte ndermjet te interesuarve.

Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje ato i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

**AKSIONERET**

**MIREL MERTIRI**
Mirel Mërtiri

**ERVIN MERTIRI** Ervin Mërtiri

**ERISELDA PACO**
Eriselda Paço

**VJOLLCA AJAZAJ**
Vjollca Ajazaj

31614

# K E R K E S E
## PER RREGJISTRIM SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE "DIGITAL CABLE NETWORK" SH.A

KERKUESI; **Mirel Mertiri**, i biri i Trifonit i datelindjes 08.08.1978, lindur dhe banues ne Fier me banim ne lagjen " 8 shkurti", Rr. "Thoma Kopace" nr. 25

OBJEKTI; Rregjistrimi ne regjistrin tregetar si person juridik ,

BAZA LIGJORE: Ne baze te ligjit me nr 7667 date 28.01.1993 , dhe te ligjit 7638 date 19.11.1992.

PERPARA

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

*T I R A N E*

Z.Kryetar!

Jam banues ne qytetin e Fierit ne rrugen "'8 shkurti " dhe duke u mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi kerkoj te rregjistrohem si person juridik prane Gjykates se shkalles se pare Tirane per te ushtruar aktivitetin tim privat me **objekt**;:

***- Ai perfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.***

***- Aktiviteti I shoqerise do te plotesohet duke respektuar paanshmerisht te drejten per informacion, bindje politike e besime fetare, personalitetin, dinjitetin , jeten private te njeriut si dhe te drejtat dhe lirite themelore te tij.***

***a e shoqerise*** *do te jete ne Tirane, Rr " Elbasanit" , perballe disko "Calvin", kati I*

**na e shoqerise**: Ajo do te krijohet dhe do te funksionoje si shoqeri aksionere.

**tor i shoqerise** " DIGITAL CABLE NETWORK" do te jete Z. **MIREL MERTIRI**.

tali themeltar i shoqerise eshte 10 000 000 (dhjetemilion) leke i perbere nga ributet e aksionereve. **Afati kohor** i ushtrimit te aktivitetit te saj do te jete per nje kohe acaktuar.

sa me siper kerkoj nga ana juaj te caktoni nje dite per te marre ne shqyrtim kerkesen si dhe miratimin e kesaj kerkese per rregjistrimin si person juridik prane zyres se jistrit tregetar te shoqerise " DIGITAL CABLE NETWORK"

**K E R K U E S I**

**DREJTOR I SHOQERISE**

**" DIGITAL CABLE NETWORK" SH.A TIRANE**

**MIREL MERTIRI**

REPUPLIKA E SHQIPERSISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 886 rep

# VERTETIM

Ne Tirane , sot me date 11.05.2004 para meje noteres **Fatbardha Kore** , anetare e Dhomes se Noterise Tirane, u paraqit personalisht Z. **Mirel Mertiri** i biri i Trifonit i datelindjes 08.08.1978, lindur dhe banues ne Fier me banim ne lagjen " 8 shkurti", Rr. "Thoma Kopace" nr. 25 , me nr. Z 0885654 te pasaportes te tij personale, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e Drejtorit te Shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" SH.A. dhe deklaroi se sa me siper, kerkesen e firmos ne baze te vullnetit te tije te lire e te plote dhe une noteria pasi bindem per vullnetin e tije te lire e te plote e legalizoje ate sipas ligjit .

*Notere*
FATBARDHA KORE

PULLE TAKSE
100 LEKE
R. SHQIPERISE

FATBARDHA KORE
NOTERE
TIRANE ALBANIA
CEL. 0682236020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISE TIRANË
Nr. 907 rep
NR. 231 kol.

**VERTETIM**

Sot më datën 11.05.2004 ( Dymijëekater), para meje Noteres Fatbardha Kore, e regjistruar në Dhomën e Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht **1. Mirel Mertiri**, i biri i Trifonit i datelindjes 08.08. 1978 ne Fier dhe banues ne Fier ne lagjen "8 Shkurti", rr. "Thoma Kopace", nr. 25, shtetas shqiptar me numër pasaporte Z 0885654 ; **2. Ervin Mertiri**, i biri i Trifonit , i datelindjes 20.03.1980 lindur ne Fier dhe banues ne Fier ne lagjen "8 Shkurti", Rr. " Thoma Kopace", nr.25; **3. Eriselda Paco** e bija e Thomait, e datelindjes 24. 02.1980 , banuese ne Tirane , Rr. "Elbasanit" , Pall.15, shk.2, ap. 15, me numër pasaporte 1224334, **4. Vjollca Ajazaj** e bija e Ilias, e datelindjes 11.11.1950, banuese në Tiranë, B "Zhan D'Ark", Pall. 20, shk. 1, ap. 18, me numër Z 0779049 te pasaportes se saj personale; të gjithë madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova nga dokumentat identifikuese sa sipër, të cilët nënshkruan në prezencën time këtë Statut dhe Aktin e Themelimit, pasi deklaruan se e kanë kuptuar mirë përmbajtjen dhe unë noterja e vertetoj rregullisht konform ligjit.

NOTERE

FATBARDHA KORE

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

NOTER TIRANE

FATBARDHA KORE
NOTERE
TIRANE ALBANIA
CEL 0682236020

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 1480 Rep

# VERTETIM

Vertetohet se sot me date _13.05.2004 para meje noteres Afrodhiti Gjebero u paraqite Mirel Mertiri, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi perkates, deklaroi se derdhi para meje shumen 10000000 leke per shoqerine ne krijim e siper "DIGITAL CABLE NETWORK" sha ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 per shoqerite Tregtare si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 Per regjistrin tregtar ;

N O T E R
AFRODHITI GJEBERO

31614/1

28 10 2004

# K E R K E S E

KERKUES: MIREL MERTIRI i biri Trifonit i datelindjes 08.08.1978, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, Mihal Grameno. Pall. 135, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

OBJEKTI: Depozitim I Vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise " Digital Cable Network" sh.a me seli ne Tirane rr. Elbasanit Pallati I ri perballe disco "Calvin" regjistruar ne regjistrin tregetar me vendim te Gjykates se Tiranes me nr 31614 date 14.05.2004

BAZA LIGJORE: Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare" dhe Neni 5, 10 dhe 16 i Statutit te Shoqerise

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Zoti Kryetar,
Ne vendimin nr. 31614 date 14.05.2004 eshte vendosur rregjistrimi I shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a. me seli ne Tirane rr. Elbasanit Pallati I ri perballe disco "Calvin".
Sipas vendimit te asamblese se ortakeve nr.2 date 31.03.2003 kerkoj depozitimin e kesaj kerkese per

- Miratimin per shitjen e aksioneve te aksionerit Mirel Mertiri ne masen 40 %, zotit Bledar Gjata sipas Kontrates se Shitjes se aksioneve.
- Pranimin si aksioner te ri te shoqerise, Z. Bledar Gjata
  Shperndarja e aksioneve ne shoqeri do te jete

- Bledar Gjata ................ 40 % te aksioneve
- Ervin Mertiri ................ 40 % te aksioneve
- Eriselda Paco ................ 15 % te aksioneve
- Vjollca Ajazaj ................ 5% te aksioneve

- Shtimi I kapitalit fillestar te shoqerise me 3.000.000 ( tre milion leke)
  1. depozitimin e dokumentave si Vendimi I asamblese se aksionereve dhe Kontraten e Shitjes se kuotave prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane per miratim.

Pra , kerkoj nga kjo Gjykate qe te caktoje nje dite per gjykimin e kerkeses time dhe te vendose per depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a , se bashku me kontraten e shitjes se kuotave

KERKUES

ADMINISTRATOR

MIREL MERTIRI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE –TIRANE
NR. 8587 REP

VERTETIM

Sot me daten 27.10.04 , para meje Noteres DRITA PEPI anetare e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Bulevardin " Zhan Dark " u paraqit personalisht, Mirel Mertiri i biri Trifonit i datelindjes 08.08.1978, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, Rr Mihal Grameno Pall 135: madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar , i cili deklaroi se sa me siper e ka redaktuar vete jashte kesaj zyre, dhe me vullnetin e tij te lire e te plote e nenshkruan ne pranine time dhe une noterja e legalizoj sipas ligjit.

NOTERE
Drita Pepi

**BANKA e TIRANES**
**TIRANA BANK**
MEMBER OF PIRAEUS BANK GROUP

071868

KODI FISKAL / FISKAL CODE: 3607408 NIPT / TAXE CODE : J 61924008 V

Branch: 0120 TIRANA 2 Branch
Rruga 'Kavajes', Kryqezimi '21 Djetori'
Tel: +355 4 269606/08/09

DIGITAL CABLE NETWORK SHA

RR ELBASANIT,P.PERBALLE D.CALVIN
TIRANE
ALBANIA

| | |
|---|---|
| Data | 8DHJ04 |
| Tipi i Deal-it | Depoz.Escrow Deri ne 1 Muaj |
| Monedha | Lek |
| Refer.Llogarise | E1MEU-071868 |
| Statusi | DEAL IRI/MODIFIK.SOT |

K O N F I R M I M I   I   D E P O Z I T E S   K O L A T E R A L

Konfirmojme depoziten e mbajtur si kolateral si me poshte

| | | |
|---|---|---|
| Shuma e depozites kolateral | | ALL 3,000,000.00 |
| Fillimi-Maturimi | 8DHJ04-OPEN | |
| Perqindja e interesit | 0.0 | |
| Taksa e interesit% | 0.0 | |
| Ditet e inter./Baza | 0/365 | |
| Shuma totale interesit | | ALL 0.00 |
| Shuma totale e takses | | ALL 0.00 |
| Shuma neto e interesit | | ALL 0.00 |

Ne fillim
BLLOKIM SHUME SI GARANCI PER MARRJE V.GJYKATE PER SHTIM KAPITALI FILLESTAR.

Ne maturim
BLLOKIM SHUME SI GARANCI PER MARRJE V.GJYKATE PER SHTIM KAPITALI FILLESTAR.

EDA HALILI

Firma(t) e Autorizuar(a)

20241/50M/01-02

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE FIER
NOTER DURIM LEKDUSHI
Nr 5010 rep.Nr 809 kol

PULLE TAKSE

Fier me 03.09.2004

***KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH***
( Baza ligjore : Neni 705 e vijues i KCivil )

Ne Fier sot me date 03.09.2004 para meje Noterit Durim Lekdushi ne studion time Noteriale te ndodhur prane gjykates se rrethit Fier u paraqiten personalisht shtetasit shqiptare;

**Shitesi :MIREL MERTIRI,** I biri I Trifonit ,lindur me 08.08.1978 ne Fier dhe banues ne Fier. Madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, I panjohur prej meje Noterit per identitetin e te cilit u binda nga pasaporte me Nr 20885654.

**Bleres : BLEDAR GJATA** ,i biri i Ganiut ,lindur me 29.01.1975 ne Fier dhe banues Fier . Madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, I panjohur prej meje per identitetin e te cilit u binda nga Pasaporte me Nr.1501812 .

Une shitesi Mirel Mertiri jam aksioneri i shoqerise anonime " DIGITAL CABLE NETWORK " sh.a dhe zoteroj 400 aksione me vlere prej 4 000 000 (kater milion )lek per aksionet me numer nga 1- 400 . Kjo shume aksionesh perben 40 % te kapitalit fillestar te shoqerise te krijuar me vendim gjykate nr. 31614 , dt. 14.05.2004 te Gjykates se Tiranes . Per shitjen e ketyre aksioneve i eshte bere njoftimi paraprak aksionereve te tjere te kesaj shoqerie nga une Mirel Mertiri per Ervin Mertirin , Eriselda Paco dhe Vjollca Ajazi te cilet me kane kthyer pergjigje po me shkrim se ja vene ne dijeni per shitjen nga ana ime dhe se nuk jane te interesuar per blerjen e ketij 40 % te aksioneve . Shkresat e tyre kane daten 25.05.2004 .
Kete sasi prej 40% te ketyre aksioneve te shoqerise qe une zoteroj ne shoqerine Sh.A "DIGITAL CABLE NETWORK" deshiroj tja shese Z. Bledar Gjata per shumen 400.000(katerqind mije )leke,te reja.
Kjo sasi lekesh eshte likujduar teresisht jashte kesaj zyre ne diten e sotme .
Une bleresi Bledar Gjata jam plotesisht dakort me blerjen e ketyre aksioneve mbasi kam kontrolluar dhe verifikuar te gjithe dokumentacionin e shoqerise dhe se e kam likujduar shumen e lekeve plotesisht .
Nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate bleresi Bledar Gjata behet pronar i vetem i 40% te aksioneve te Shoqerise Aksionere " DIGITAL CABLE NETWORK" , dhe gezon te gjitha tagrat e pronarit te vetem te ketyre aksioneve .
Kete kontrate palet pasi e lexojne e gjejne konforme vullnetit te tyre e miratojne duke e nenshkruar ate ne prezencen time .
Une noteri vertetoj aktin duke e nenshkruar ate .

| PALA SHITESE | NOTER DURIM LEKDUSHI | PALA BLERESE |
|---|---|---|
| Mirel Mertiri | | Bledar Gjata |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA AKSIONERE
" DIGITAL CABLE NETWRK" sh.a TIRANE

WU 8588 Tep

**VENDIM I ASAMBLESE SE AKSIONEREVE**

Nr. 1 DATE 27.10.04

Ne Tirane , sot me daten 27.10.04 Asambleja e Aksionereve te Shoqerise "DIGITAL CABLE NETWRK " sh.a . me pjesemarrjen e aksionereve MIREL MERTIRI, ERVIN MERTIRI, ERISELDA PACO, VJOLLCA AJAZAJ BLEDAR GJATA dhe te noteres DRITA PEPI me numer license 3912895 shqyrtoi:

RENDIN E DITES

- Miratimin per shitjen e aksioneve te aksionerit Mirel Mertiri ne masen 40 % , zotit Bledar Gjata sipas Kontrates se Shitjes se aksioneve.
- Pranimin si aksioner te ri te shoqerise, Z. Bledar Gjata
- Shtimi i kapitalit fillestar te shoqerise me 3.000.000 ( tre milion leke)
- Depozitimin e dokumetave si Vendimi I Asamblese se Ortakeve dhe Kontrates se Shitjes prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane per miratim.

Mbledhja mbahet ne prani te aksionereve.

- Mirel Mertiri ................ 40 % te aksioneve
- Ervin Mertiri ................ 40 % te aksioneve
- Eriselda Paco ................. 15 % te aksioneve
- Vjollca Ajazaj ................ 5% te aksioneve

Si edhe te noteres Drita Pepi te cilet marrin pjese personalisht ne Mbledhjen e Asamblese. Asambleja e Ortakeve me Vendim te Ortakeve duke u mbeshtetur ne ligjin " Per Shoqerite Tregetare",dhe ne nenin 7 te statutit te shoqerise unanimisht :

VENDOSI

- Miratimin per shitjen e aksioneve te aksionerit Mirel Mertiri ne masen 40 % , zotit Bledar Gjata sipas Kontrates se Shitjes se aksioneve.
- Pranimin si aksioner te ri te shoqerise, Z. Bledar Gjata

Shperndarja e aksioneve ne shoqeri do te jete

| | | |
|---|---|---|
| Bledar Gjata | ................ | 40 % te aksioneve |
| Ervin Mertiri | ................ | 40 % te aksioneve |
| Eriselda Paco | .................. | 15 % te aksioneve |
| Vjollca Ajazaj | .................. | 5% te aksioneve |

- Shtimi i kapitalit fillestar te shoqerise me 3.000.000 ( tre milion leke)

- Per depozitimin e dokumetave si Vendimi i Asamblese se Ortakeve dhe Kontrates se Shitjes prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane caktohet administratori i shoqerise Z. MIREL MERTIRI.

ORTAKET

MIREL MERTIRI ERVIN MERTIRI VJOLLCA AJAZAJ ERISELDA PACO

BLEDAR GJATA

NOTERE

DRITA PEPI

# AKTI I THEMELIMIT
# I SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE
# "DIGITAL CABLE NETWORK" SH.A

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" , ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar" dhe ligjit nr. 8410 date 30.09.1998 " Per Radio-Televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise", aksioneret z. **Mirel Mertiri**, z.**Ervin Mertiri, Zj. Eriselda Paco dhe Zj Vjollca Ajazaj** me vullnetin e tyre te lire rane dakort te krijojne shoqerine anonime " DIGITAL CABLE NETWORK " Sh.A

**Neni 1**

**Forma**

Shoqeria "DIGITAL CABLE NETWORK " sh.a eshte themeluar ne formen e shoqerise anonime nga akti I themelimit dhe nga statuti I saj.

Shoqeria vepron ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregetar ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane.

**Neni 2**
**Emertimi**

Emertimi I shoqerise do te jete "DIGITAL CABLE NETWORK "sh.a

**Neni 3**
**Selia**

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, rr: " Elbasanit", Pall. I ri perballe disko "Calvin", kati I pare.

Ajo mund te transferohet ne cdo vend tjeter te rrethit te Tiranes ose kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise sipas menyres te parashikuar ne Statut apo nga ligjet ne fuqi.

**Neni 4**
**Kohezgjatja e Shoqerise**

PULLE TAKSE

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me nje kohezgjatje te pakufizuar.

**Neni 5**
**Objekti**

Ai perfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.

REPUBLIKA E SHQIPERISE DHOMA E NOTEREVE TIRANE NR 7851 REP DT 06.10.04 VERTETIM VERTETOHET NJESIA ME ORIGJINALIN Notere DRITA PEPI

- Aktiviteti I shoqerise do te plotesohet duke respektuar paanshmerisht te drejten per informacion, bindje politike e besime fetare, personalitetin, dinjitetin , jeten private te njeriut si dhe te drejtat dhe lirite themelore te tij.

**Neni 6**

Shoqeria mund te financohet nepermjet reklames dhe sponsorizimeve ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Sipas legjislacionit ne fuqi dhe per arritjen e objektit te shoqerise dhe qellimeve te saj, shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte qe lidhen me qellimin e mesiperm, te marre interesa joaksionere ne shoqeri apo persona te tjere juridike te cilet mund te kene qellime te tjera por qe lidhen me aktivitet televiziv. Ajo mund te jape garanci dhe/ose mund te hipotekoje ne favor te ndonje banke, instituti krediti dhe financiar.

Aktiviteti I shoqerise do te zhvillohet ne perputhje me aktet normative te Republikes se Shqiperise dhe ne menyre te vecante me ligjin nr. 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare" dhe ligjin nr. 8410 date 30.09.1998 "Per radio- televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise".

**Neni 7**

- Kapitali themeltar I shoqerise eshte 10 000 000 leke (dhjetemilion leke), I ndare ne 1000 (njmije) aksione nominative dhe te rregjistruara me nje vlere nominale prej 10 000 (dhjete mije) lekesh secila. Kapitali I shoqerise formohet nga kontributet e meposhtme ne para dhe ne natyre.

1 **z. Mirel Mertiri** zoteron 400 (katerqind) aksione me nje vlere prej 4 000 000 (kater milion) lekesh, per aksionet me Nr. 1 deri N.400 qe perfaqeson 40 % te kapitalit te shoqerise

2 **z. Ervin Mertiri** zoteron 400 (katerqind) aksione me nje vlere prej 4 000 000 (kater milion) lekesh, per aksionet me Nr. 400 deri N.800, qe perfaqeson 40 % te kapitalit te shoqerise

3. **Zj Eriselda Paco** zoteron 150 (njeqind e pesedhjete) aksione me nje vlere prej 1 500 000 (nje milion e peseqind mije) lekesh, per aksionet me Nr. 800 deri N. 950, qe perfaqeson 15 % te kapitalit te shoqerise.

4. **Zj Vjollca Ajazaj** , zoteron 50 (pesedhjete) aksione me nje vlere prej 500 000 (peseqind mije) lekesh, per aksionet me Nr. 950 deri N. 1000, qe perfaqeson 5 % te kapitalit te shoqerise.

**Neni 8**

Fitimi I realizuar nga Shoqeria mbas derdhjes se detyrimeve ligjore dhe zbritjes se fondeve te detyruara, do te ndahet mes aksionereve te shoqerise perpjestimisht me kontributet e tyre ne kapitalin themeltar.

**Neni 9**

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Mbledhja e Asamblese se Aksionereve
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtoria

**Neni 10**

Asamblete e pergjithshme te aksionereve perfaqeson teresine e aksineve te dhe cilesohen asamble te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve qe ato jane thirrur per te marre.

Cdo asamble e pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se pergjithshme detyrojne te gjithe aksioneret madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo qe votojne kunder.

**Neni 11**

- Keshilli mbikqyres perbehet prej tre anetaresh.
- Ne baze te nenit 105 te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare" anetaret e keshillit mbikqyres jane zgjedhur:

  a- **Naim Kacorri** I biri I Hasanit banues ne Tirane rr. "Kavajes" pallati13 ap 6 me nr. pas Z 0710187

  b- **Pajtim Ajazaj** I biri I Shyqyriut I datelindjes 27.09.1946 banues ne Tirane B." Zhan D'Ark " pall 20, shk.1, ap. 18 me nr pas Z 0779048

  c- **Artan Qamili** banues ne Tirane Lagja "Ali Demi" pall 2 shk.2 me nr pasaporte 0587305

Mandati I anetareve te keshillit mbikqyres eshte 3 vjet dhe mund te rizgjidhen.

**Neni 12**

-Shoqeria drejtohet nga nje drejtori e perbere nga nje drejtor. Drejtori mund edhe te mos jete aksioner. Drejtori nuk mund te jete anetar I Keshillit Mbikqyres.

- Drejtori emerohet per nje afat tre vjetesh me te drejte rizgjedhjeje

- Drejtoria ka kopetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise, por kufizohet nga ato kopetenca qe ligji ua ka dhene shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe asamblese se aksionereve.

**Neni 13**

Prishja dhe likuidimi I shoqerise behet ne perputhje me statutin e saj, duke zbatuar rigorozisht rregullat e percaktuara ne ligjin "Per shoqerite tregetare"

**Neni 14**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likujdimit te saj midis shoqerise dhe aksionereve ose midis vete aksionereve,lidhur me veprimtarine e shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejte ndermjet te interesuarve.

Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje ato i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

**AKSIONERET**

**MIREL MERTIRI**
Mirel Mërtiri

**ERVIN MERTIRI**
Ervin Mërtiri

**ERISELDA PACO**
Eriselda Paço

**VJOLLCA AJAZAJ**
Vjollca Ajazaj

# STATUTI
# I SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE
# "DIGITAL CABLE NETWORK" SH.A

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" , ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar" dhe ligjit nr. 8410 date 30.09.1998 " Per Radio-Televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise", aksioneret z. **Mirel Mertiri**, z. **Ervin Mertiri**, **Zj. Eriselda Paco dhe Zj Vjollca Ajazaj** me vullnetin e tyre te lire rane dakort te krijojne shoqerine anonime " DIGITAL CABLE NETWORK " Sh.A

## KREU I

## EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA

### Neni 1

### Forma

Shoqeria "DIGITAL CABLE NETWORK " sh.a eshte themeluar ne formen e shoqerise anonime nga akti I themelimit dhe nga ky statut.

Shoqeria vepron ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregetar ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane.

### Neni 2
### Emertimi

Emertimi I shoqerise do te jete "DIGITAL CABLE NETWORK " sh.a.

### Neni 3
### Selia

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, rr: " Elbasanit", Pall. I ri perballe disko "Calvin", kati I pare.

Ajo mund te transferohet ne cdo vend tjeter te rrethit te Tiranes ose te nje rrethi kufitar me nje vendim te thjeshte te keshillit mbikeqyres ,vendim ky qe do te ratifikohet nga asambleja e pergjithshme e zakonshme me e afert.

Selia e shoqerise mund te transferohet kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise ne baze te nje vendimi te asamblese se pergjethshme te jashtezakonshme te aksionereve.

Ne rastin e nje transferimi me vendim te keshillit mbikeqyres ky I fundit eshte I autorizuar te beje ndryshimin e duhur ne statut.

Keto vendime depozitohen ne rregjistrin tregetar.

### Neni 4
### Kohezgjatja e Shoqerise

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me nje kohezgjatje te pakufizuar.

## KREU II

### Neni 5
### Objekti

- Ai perfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.
- Aktiviteti I shoqerise do te plotesohet duke respektuar paanshmerisht te drejten per informacion, bindje politike e besime fetare, personalitetin, dinjitetin , jeten private te njeriut si dhe te drejtat dhe lirite themelore te tij.

### Neni 6

Shoqeria mund te financohet nepermjet reklames dhe sponsorizimeve ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Sipas legjislacionit ne fuqi dhe per arritjen e objektit te shoqerise dhe qellimeve te saj, shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimet ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte qe lidhen me qellimin e mesiperm, te marre interesa joaksionere ne shoqeri apo persona te tjere juridike te cilet mund te kene qellime te tjera por qe lidhen me aktivitet televiziv. Ajo mund te jape garanci dhe/ose mund te hipotekoje ne favor te ndonje banke, instituti krediti dhe financiar.

Aktiviteti I shoqerise do te zhvillohet ne perputhje me aktet normative te Republikes se Shqiperise dhe ne menyre te vecante me ligjin nr. 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare" dhe ligjin nr. 8410 date 30.09.1998 "Per radio- televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise".

## KREU III

### AKSIONET / KAPITALI

### Neni 7

- Kapitali themeltar I shoqerise eshte 10 000 000 leke (dhjetemilion leke), I ndare ne 1000 (njmije) aksione nominative dhe te rregjistruara me nje vlere nominale prej 10 000 (dhjete mije) lekesh secila. Kapitali I shoqerise formohet nga kontributet e meposhtme ne para dhe ne natyre.

1. **z. Mirel Mertiri** zoteron 400 (katerqind) aksione me nje vlere prej 4 000 000 (kater milion) lekesh, per aksionet me Nr. 1 deri N.400 qe perfaqeson 40 % te kapitalit te shoqerise
2. **z. Ervin Mertiri** zoteron 400 (katerqind) aksione me nje vlere prej 4 000 000 (kater milion) lekesh, per aksionet me Nr. 400 deri N.800, qe perfaqeson 40 % te kapitalit te shoqerise
3. **Zj Eriselda Paco** zoteron 150 (njeqind e pesedhjete) aksione me nje vlere prej 1 500 000 (nje milion e peseqind mije) lekesh, per aksionet me Nr. 800 deri N. 950, qe perfaqeson 15 % te kapitalit te shoqerise.

4. **Zj Vjollca Ajazaj** , zoteron 50 (pesedhjete) aksione me nje vlere prej 500 000 (peseqind mije) lekesh, per aksionet me Nr. 950 deri N. 1000, qe perfaqeson 5 % te kapitalit te shoqerise.

- Cdo aksion eshte I pandashem dhe siguron te drejten e nje vote.
- Transferimi I pronesise mbi aksionet nje personi te trete, me perjashtim te rasteve te trashegimise, I nenshtrohet te drejtes se parablerjes ne favor te aksionereve te tjere, te cilet mund te ushtrojne kete te drejte brenda 20 ditesh nga marrja e letres te derguar me poste rekomande ose me faks qe permban oferten e blerjes. Te gjitha njoftimet qe parashikohen ne kete nen duhet ti adresohen edhe shoqerise.
- Ne rastin e rritjes se kapitalit te shoqerise aksionet e reja I ofrohen aksionereve ne perpjestim me numrin e aksioneve te zoteruara prej tyre ne baze te nenit 155 dhe vijues te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme.
- Ne rast shkaterrimi ose humbje te certifikates, drejtoria mund te leshoje certifikata te reja dhe mund te percaktoje afate dhe kushte qe I konsideron te pershtatshme per te mbrojtur shoqerine nga ndonje padi e cila mund te ngrihet kunder saj lidhur me cfaredolloj certifikate e cila pretendohet te kete humbur ose te jete shkaterruar.

## Neni 8
## Zmadhimi I kapitalit

Kapitali themeltar I shoqerise mund te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara ne nenet 150 deri 163 te ligjit "Per Shoqerite tregtare".

Zmadhimi I kapitalit themeltar mund te kryhet vetem me vendim te asamblese se jashtezakonshme te aksionereve , ne baze te raportit te drejtorise, I cili permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Aksioneret kane te drejten e perparesise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit.Kjo e drejte eshte perpjestimore me shumen e aksioneve te zoteruara nga secili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit.

Aksioneret mund te heqin dore vetem individualisht nga e drejta per nenshkrimin e aksioneve te reja.Ata munden gjithashtu te kerkojne nenshkrimin e nje numri me te vogel aksionesh nga sa u takon sipas parimit te perpjestueshmerise, por me kusht qe asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete.

## Neni 9

## Format e aksioneve dhe libri I aksioneve

Aksionet jane te formes emerore .

Pronesia e aksioneve rezulton nga rregjistrimi tyre ne emer te titullarit ose titullareve ne librin e aksioneve te mbajtura nga ana e shoqerise ose nga ndermjetesat financiar.

Secili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje nxjerrje (ekstrakt) nga libri I aksionereve I cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Secili aksioner ka te drejte te verifikoje nese emri I tij eshte futur ne librin e aksionereve dhe personi i cili mban librin eshte I detyruar ti tregoje aksionerit, me kereksen e ketij te fundit,hyrjen perkatese ne liber.

## KREU IV

### Neni 10

**Asambleja e Aksionereve/Natyra e asamblese dhe karakteri detyrues I vendimeve**

Asamblete e pergjithshme te aksionereve cilesohen asamble te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve qe ato jane thirrur per te marre.

Cdo asamble e pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se pergjithshme detyrojne te gjithe aksioneret madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo qe votojne kunder.

### Neni 11

**Thirrja dhe vendi I asamblese**

Asamblete e pergjithshme thirren nga Keshilli Mbikeqyres ose nga drejtoria. Ato mund te thirren gjithashtu, nga Eksperti kontabel I autorizuar I pavarur ne rast urgjence, nga nje mandatmbajtes I caktuar nga gjykata dha ,kur eshte rasti nga likujduesi.

Asamblete e pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te treguar me thirrje.

Thirrja e asamblese se aksionereve behet me ane te njoftimit qe I dergohet cdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi duhet te bjere ne doren e aksionereve apo te njihet prej tyre 15 dite perpara mbledhjes se asamblese dhe duhet te permbaje diten, oren dhe vendin e mbledhjes, natyren e asamblese, dhe rendin e dites .

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar quorumi I kerkuar mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare ne te njejtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes se mbledhjes se dyte rikujtojne daten dhe rendin e dites.

### Neni 12

**Rendi I dites**

Rendi I dites se mbledhjes se asamblese percaktohet nga autori I thirrjes .Nje ose disa aksionere qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit themeltar te shoqerise kane te drejte te kerkojne qe te futen ne rendin e dites nje apo disa projektrezoluta.

Keto projektrezoluta dergohen ne seline e shoqerise te shoqeruara me nje kerkese ne te cilen tregohen edhe arsyet ,si dhe me nje dokument qe provon zoterimin e pjeses se kapitalit themeltar te kerkuar nga paragrafi I dyte I ketij neni.

Projektrezoluta dhe dokumentet shoqeruese duhet te mberrijne ne seline e shoqerise te pakten 5 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

Asambleja e aksionereve nuk mund te marre ne shqyrtim nje ceshtje qe nuk eshte perfshire ne rendin e dites.Megjithate ajo mundet ,ne cdo rrethane ,te shkarkoje nje ose disa anetare te Keshillit Mbikeqyres dhe te beje zevendesimin e tyre.

## Neni 13

## Evidenca e pjesemarrjes, drejtimi I mbledhjes dhe proces verbalet

Mbledhjet e asamblese drejtohen nga Presidenti I Asamblese se ortakeve I cili zgjidhet ne mbledhjen e pare te asamblese dhe ne mungese te tij, nga zevendesi apo nje aksioner tjeter I emeruar nga asambleja e aksionereve. Ne rastet kur thirrja e mbledhjes eshte bere nga Eksperti Kontabel I Autorizuar, mandatmbajtesi I caktuar nga gjykata apo likuiduesi, mbledhja drejtohet nga autori I thirrjes, asambleja cakton nje sekretar te asamblese I cili nuk mund te jete edhe aksioner.

Aksioneret mund te zgjedhin qe te perfaqesohen ne mbledhjen e aksionereve me nje prokure te leshuar nga nje aksioner tjeter ose nga bashkeshorti/ja e tij/saj.

Per cdo mbledhje te asamblese hartohet nje procesverbal ,I cili permban:

-daten dhe vendin e mbledhjes

-menyren e thirrjes

-rendin e dites

-drejtuesi I mbledhjes dhe komisioni I vezhgimit

-numri I aksioneve qe marrin pjese ne votim

-quorumi I arritur

-permendjen e dokumenteve dhe te raporteve qe jane shtruar ne mbledhje

-nje permbledhje te debateve

-tekstet e projektrezolutave te vena ne votim, ato te miratuara dhe ato te hedhura poshte nga aksioneret

-rezolutat e votimeve

Procesverbalet e mbledhjes te asamblese hartohen ne nje rregjister te posacem, I numertuar dhe I vulosur,I cili ruhet ne seline e shoqerise.

## Neni 14

## Asamblete e pergjithshme te zakonshme

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit , brenda 6 muajve te vitit pasaardhes, per te vendosur mbi llogarite e shoqerise per ushtrimin financiar te mbyllur. Ajo ka ,midis te tjerash ,kompetencat qe vijojne :

-te miratoje strategjine e zhvillimit afatgjate te shoqerise

-te miratoje plan-biznesin dhe planin financiar vjetor

-te miratoje , ndryshoje ose te hedhe poshte llogarite vjetore qe I jane shtruar per miratim

-te vendose per shperndarjen dhe destinimin e rezultatit ne pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin.

-te emeroje dhe shkarkoje anetaret e Keshillit Mbikeqyres

-te shkarkoje me propozim te Keshillit Mbikeqyres, anetaret e drejtorise

-te emeroje ekspertin ose ekspertet kontabel te autorizuar

-te miratoje ose te mosmiratoje emerimet e anetareve te Keshillit Mbikeqyres te kryera nga vete keshilli si emerime te perkohshme

-te caktoje shperblimin e vecante dhe shperblime te tjera te parashikuara ne kete statut per Keshillin Mbikeqyres

-te vendose per raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar lidhur me marreveshjet qe I nenshtrohen autorizimit paraprak te Keshillit Mbikeqyres.

Asambleja e zakonshme merr cdo vendim qe nuk sjell ndryshime te statutit.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.

Ne perputhje me sa parashikohet nga neni 20 I ligjit 8410 date 30.09.1998 " Per radio dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, asambleja e zakonshme e aksionereve eshte vlefshmerisht e mbledhur ne thirrjen e pare dhe te dyte kur eshte e pranishme apo e perfaqesuar me prokure te pakten 2/3 e aksioneve .

**Neni 15**

**Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme.**

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mblidhet sa here qe duhet te merret nje vendim qe sjell ndryshime te ketij statuti.

Ajo nuk mund te shtoje detyrimet e aksionereve pervec operacioneve qe rrjedhin nga rigrupimi I aksioneve I kryer rregullisht.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 3/4 e aksioneve me te drejte vote. Per mbledhjen e dyte ky quorum eshte jo me pak se 1/2 e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme merren me shumicen prej 3/4 te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem.

Asambleja e jashtezakonshme vendos per :

1. Modifikim ose ndryshim ne statutin e shoqerise.
2. Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise.
3. Marrjen e huave nga shoqeria, dhenien e paradhenieve nga ato, berjen dorezanes ose te garantoje detyrimet ndaj te treteve.
4. Zgjedhjen e likujdatorit.
5. Zgjatjen ose shkurtimin e kohezgjatjes se veprimtarise se shoqerise dhe per shkrirjen bashkimin, ose prishjen e shoqerise.
6. Themelimin e shoqerive te reja ose pjesemarrjen ne shoqeri te tjera.
7. Shitja ose shkembimi I pasurive qe perbejne fondin arkivor te shoqerise.

- Ne perputhje me sa parashikohet nga neni 20 I ligjit 8410 date 30.09.1998 " Per radio dhe televizionin publik dhe privat ne Republiken e Shqiperise" dhe me ndryshimet dhe plotesimet e mevoneshme, asambleja e jashtezakonshme e aksionereve eshte vlefshmerisht e mbledhur ne thirrjen e pare dhe te dyte kur eshte e pranishme apo e perfaqesuar me prokure te pakten 2/3 e aksioneve .

-Ne rast se ky quorum nuk arrihet qe ne mbledhjen e pare mbledhja e dyte e asamblese mund te shtyhet per nje date te mevoneshme por jo me vone se dy muaj nga data e thirrjes se mbledhjes se pare.

- Asambleja e jashtezakoneshme e aksionereve vendos me nje shumice te votave prej ¾ qe I perkasin aksionereve te pranishem apo te perfaqesuar.Ne mbledhjen e dyte vendimi merret meshumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

## Neni 16

**Venia ne dispozicion te aksionereve te dokumentave dhe informacioneve.**

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe ne afatet e parashikuara nga ligji , raportet, dokumentet dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje dokumenti tjeter te caktuar nga asambleja , dokumentet qe duhet t'u vihen ne dispozicion aksionereve u dergohen ketyre bashke me njoftim-thirrje per mbledhje.

## KREU V

## ADMINISTRIMI I SHOQERISE KESHILLI MBIKQYRES

## Neni 17

**Perberja e keshillit mbikqyres**

1- Keshilli mbikqyres perbehet prej tre anetaresh.

2- Ne baze te nenit 105 te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare" anetaret e keshillit mbikqyres jane zgjedhur:

   a- **Naim Kacorri** I biri I Hasanit banues ne Tirane rr. "Kavajes" pallati13 ap 6 me nr. pas Z 0710187

   b- **Pajtim Ajazaj** I biri I Shyqyriut I datelindjes 27.09.1946 banues ne Tirane B." Zhan D'Ark " pall 20, shk.1, ap. 18 me nr pas Z 0779048

   c- **Artan Qamili** banues ne Tirane Lagja "Ali Demi" pall 2 shk.2 me nr pasaporte 0587305

3- Mandati I anetareve te keshillit mbikqyres eshte 3 vjet dhe mund te rizgjidhen. Anetaret e emeruar nga asambleja e aksionereve dhe ata te zgjedhur nga punemarresi mund te revokohen per cdo arsye nga asambleja e aksionereve. Anetaret e zgjedhur nga punemarresit mund te revokohen edhe per rastet e parashikuara ne ligj dhe nga ky statut.

4- Ne rast vdekjeje, shkarkimi apo doreheqjeje, vendet vakant ne keshillin mbikqyres mund te zevendesohen brenda tre muajsh. Anetari I keshillit mbikqyres I emeruar per te zevendesuar nje anetar tjeter do te qendroje ne detyre per te gjithe kohen e mbetur te mandatit te paraardhesit.

5- Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te marrin pjese ne me shume se nente keshilla mbikqyres te tjere te shoqerive anonime te cilat seline e kane ne R.Sh.

6- Asambleja e aksionereve mund te caktoje shperblim per anetaret e keshillit mbikqyres sic eshte parashikuar nga ligji.

## Neni 18

**Kryetari dhe zevendeskryetari I Keshillit Mbikeqyres**

Keshilli Mbikeqyres zgjedh nga gjiri I tij nje kryetar dhe nje zevendeskryetar qe ngarkohen me mbledhjen e keshillit dhe drejtimin e debatit gjate seancave te tij.

Kryetari dhe zevendeskryetari I Keshillit Mbikeqyres jane detyrimisht persona fizike dhe nuk mund te zgjidhen ndermjet perfaqesuesve te personave juridike.

Ata ushtrojne funksionet e tyre gjate periudhes se mandatit ne Keshillin Mbikeqyres.

Kryetari dhe zevendeskryetari I Keshillit Mbikeqyres jane te rizgjedhshem.

Keshilli Mbikeqyres mund te emeroje nje sekretar te zgjedhur midis anetareve te keshillit ose jashte tyre duke caktuar kohezgjatjen e funksioneve te ketij.

**Neni 19**
**Mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres .**

Keshilli Mbikeqyres mblidhet me thirrjen e kryetarit , ose ne rast pengimi te ketij te zevendeskryetarit, sa here qe e kerkon interesi I shoqerise dhe te pakten nje here ne tre muaj per te degjuar raportin e drejtorise.

Thirrja e keshillit behet me te gjitha menyrat. Kryetari I Keshillit Mbikeqyres duhet te therrase mbledhjen e keshillit brenda nje afati prej 15 ditesh kur te pakten nje anetar I drejtorise ose nje e treta e anetareve te keshillit mbikeqyres I paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete. N.q.s. kerkeses nuk I jepet udhe autoret e saj mund te procedojne vete ne thirrjen e mbledhjes te Keshillit Mbikeqyres duke treguar rendin e dites te mbledhjes. Mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres mbahen ne seline e shoqerise .

Rendi I dites vendoset nga kryetari ose ne mungese te tij nga zevendeskryetari , ose nga anetari I drejtorise apo anetaret e Keshillit Mbikeqyres qe kane kerkuar thirrjen e mbledhjes.

Cdo anetar I keshillit mbikeqyres mund ti jape mandat nje anetari tjeter per ta perfaqesuar ne nje seance te keshillit.Cdo anetar mund te jape vetem nje mandat per te njejten seance.

Shqyrtimet dhe vendimet e keshillit mbikeqyres jane te vlefshme kur numri I anetareve te pranishem ne mbledhje eshte te pakten sa gjysma e anetareve ne funksion.

Vendimet merren me shumicen e votave te anetareve te pranishem dhe te perfaqesuar.

Ne rast votash te barabarta ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Ne seline e shoqerise mbahet nje rregjister I pranise I cili firmoset nga anetaret e keshillit pjesemarres ne seance.

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikeqyres evidentohen me procesverbale te hartuara ne nje rregjister te posacem, I numertuar dhe I vulosur, qe mbahet ne selite e shoqerise, ne te cilin tregohen anetaret e pranishem , te perfaqesuar dhe qe mungojne , si edhe cdo person qe ka asistuar ne mbledhje, teresisht apo pjeserisht.

Procesverbalet firmosen nga drejtuesi I mbledhjes dhe nga nje anetar I keshilli.

**Neni 20**
**Kompetencat e Keshillit Mbikeqyres**

Keshilli Mbikeqyres ushtron kontrollin e perhershem te drejtimit dhe administrimit te shoqerise nga ana e drejtorise .

Keshilli Mbikeqyres miraton strukturen organizative te shoqerise dhe ndryshimet e saj ,kriteret e punesimit dhe te pagave si dhe rregulloren e brendshme te shoqerise.

Ne cdo kohe te vitit Keshilli Mbikeqyres kryhen te gjitha verifikimet dhe kontrollet qe ai cmon te arsyeshme dhe ka te drejte te kerkoje te njihet me dokumentat qe ai gjykon te nevojshme per permbushjen e funksioneve te tij.Njehere ne tre muaj ai merr nje raport te paraqitur nga drejtoria.

Brenda tre muajve nga mbyllja e cdo viti financiar drejtoria I paraqet atij me qellim verifikimi dhe kontrolli , llogarite vjetore , si dhe nje raport te shkruar per gjendjen e shoqerise dhe aktivitetet e saj gjate vitit financiar te mbyllur.

Keshilli mbikqyres I paraqet asamblese se aksionereve komentet e tij mbi raportin vjetor te nxjerre nga drejtoria ne perputhje me nenin 130 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

## KREU VI
## DREJTORIA / BORDI DREJTUES

### Neni 21
### Drejtoria

1-Shoqeria drejtohet nga nje drejtori e perbere nga nje drejtor. Drejtori mund edhe te mos jete aksioner. Drejtori nuk mund te jete anetar I Keshillit Mbikqyres.

2- Drejtori emerohet per nje afat tre vjetesh me te drejte rizgjedhjeje

3- Drejtori eshte perfaqesues ligjor I shoqerise. Drejtor I shoqerise eshte Z. **Mirel Mertiri.**

4- Keshilli mbikqyres cakton masen e shperblimit per drejtorin ne momentin e emerimit.

5- Drejtori mund te shkarkohet nga keshilli mbikqyres ne cdo kohe per arsye te perligjura te parashikuara ne nenin 98 te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare".

6- Ne rast se posti I drejtorit mbetet bosh per shkak vdekjeje, doreheqjeje, shkarkimi, paaftesie ne pune, te nje prej anetareve te tij apo cdo shkaku tjeter, pasardhesi qe do te plotesoje vendin do te zgjidhet nga keshilli mbikqyres ne mbledhjen e pare qe ndjek lenien bosh te vendit. Drejtori I zgjedhur ne kete menyre do te qendroje ne detyre per te gjithe kohen e mbetur te mandatit te paraardhesit te tij.

### Neni 22

### Mbledhja e drejtorise

- Drejtori therret mbledhjen e drejtorise, nese ajo ekziston, duke percaktuar rendin e dites, ne cdo kohe qe e quan te nevojshme apo ne rast se ai merr kerkese me shkrim nga te pakten1/3 (nje e treta) e anetareve te drejtorise. Kerkesa duhet te permbaje listen e ceshtjeve apo temave qe duhen diskutuar. Ne rast se drejtori refuzon te therrase mbledhjen brenda 5 ( pese) diteve nga marrja e kerkeses , mbledhja mund te thirret nga kerkuesit. Drejtoria do te thirret me ane te nje letre rekomande, telegrami ose faksi, ose e-mail te derguar te pakten tre dite perpara mbledhjes. Ne raste urgjente mbledhja mund te thirret telegrami ose faksi, ose e-mail te derguar nje dite perpara dites se caktuar te mbledhjes. Ne rast se drejtori mungon per ndonje arsye, nuk ka mundesi te marre pjese ne mbledhje, te gjitha funksionet e percaktuara ne kete nen I kalojne zevendes drejtorit nese ka ose drejtorit me te vjeter ne detyre. Drejtoria do te mblidhet ne menyre te vlefshme edhe nese nuk eshte bere njoftimi formal I thirrjes me kusht qe te gjithe drejtoret te jene te pranishem dhe te informua per rendin e dites qe do te diskutohet.
- Mbledhja e Drejtorise do te mbahet te pakten nje here ne tre muaj ne seline e shoqerise ose ne ndonje vend tjeter ne Shqiperi apo jashte, dhe mund te zhvillohen edhe telekonferenca ose videokonferenca ose me ane te mjeteve te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjithe pjesemarresit te identifikohen dhe tu jepet mundesia te ndjekin diskutimet dhe te marrin pjese aktive ne to. Nese ekzistojne keto kushte drejtoria quhet e mbledhur ne vendin ku ndodhet drejtori dhe sekretari I mbledhjes, me qellim qe te mbajne procesverbalin dhe ti firmosin ato.
- Mbledhjet e drejtorise quhen te mbledhura ne menyre te vlefshme kur jane te pranishem shumica e drejtoreve nese ka. Vendimet e drejtorise jane te vlefshme kur

miratohen me voten pro te shumices se anetareve te drejtorise te pranishem.Ne rast votash te barabarta vota e drejtorit eshte vendimtare.

**Neni 23**
**Kompetencat e drejtorise**

Drejtoria ka kopetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise, por kufizohet nga ato kopetenca qe ligji ua ka dhene shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe asamblese se aksionereve.

Drejtoria I ushtron kopetencat e veta brenda objektit te shoqerise.

Ne mardheniet me te tretet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorise edhe kur keto akte nuk kane te bejne me objektin e shoqerise pervec kur provon se te tretet e dinin apo duhet ta dinin se keto akte ishin jashte objektit te shoqerise.

Merr masat te rregullit te brendeshem qe nuk u kundevihen te treteve. Per perfundimin e operacioneve te renditura me poshte drejtoria vepron me autorizim paraprak te Keshillit Mbikqyres.

a.Dhenia e dorezanive dhe garancive

b.Kryerja e investimeve tej atyre te parashikuara ne programin financiar vjetor

c.Hapja e veprimtarise ose degeve te reja,shkrirja bashkimi dhe mbyllja teresisht ose pjeserisht e veprimtarive dhe degeve te shoqerise.

d.Pjesmarrja ne shoqeri te tjera te krijuara ose per te krijuar

e.Shitja dhe shkembimi I pasurive qe perbejne aktive te qendrueshme te shoqerise

f.Negocimi, perfundimi a ndryshimi I cdo kontrate me afat ose per nje shume mbi kufijte e percaktuar cdo vit nga keshilli mbikqyres.

Kur nje operacion kerkon autorizimin e Keshillit Mbikqyres dhe ky I fundit e refuzon kete, drejtoria mund te therrase asamblene e pergjithshme dhe I parashtron asaj ceshtjen.Asambleja e pergjithshme vendos per kryerjen ose jo te operacionit.

**Neni 24**
**Bordi drejtues**

Drejtoria mund te emeroje nje Bord Drejtues, te cilit mund t'I kerkoje nje mendim, I cili nuk ka fuqi detyruese mbi disa ceshtje te rendesise se vecante ne drejtimin e aktivitetit te shoqerise.

Bordi Drejtues do te perbehet nga 7 anetare te zgjedhur ndermjet personave me moral dhe prestigj te padiskutueshem. Nuk do te kete mosperputhje te detyres mes anetarit te Bordit Drejtues dhe nje funksionari tjeter ne shoqeri.

Anetaret e Bordit Drejtues qendrojne ne detyre per 2 (dy) vjet dhe mund te rizgjidhen.

## KREU VII
## KONTABILITETI/ VITI FINANCIAR/ BILANCI VJETOR

**Neni 25**
**Kontrolli kontabel**

Kontrolli kontabel I brendshem I shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel te autorizuar, te emeruar per nje vit financiar.

Eksperti kontabel emerohet nga Asambleja e Zakonshme.

Ne baze te nenit 93 te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare", ekspert kontabel I pare emerohet **z. Myzafer Gura**

**Neni 26**
**Viti financiar/ Inventari/ Bilanci**

Viti financiar fillon ne date 1 janar dhe mbyllet ne date 31 dhjetor te cdo viti.

Drejtoria mban nje rregjister te rregullt te pasurise dhe te aktivitetit te tij ne perputhje me ligjin. Ne fund te vitit financiar, Drejtoria harton dhe bilancin vjetor per ate vit financiar.

**Neni 27**
**Rezultati I vitit financiar/ Percaktimi I fitimit**

Drejtoria harton bilancin vjetor ne perputhje me ligjin. 5 % e fitimit neto qe rezulton nga bilanci I miratuar ne baze te dispozitave te ligjit te mbahet per rezerven kryesore deri sa kjo rezerve te arrije 10 % te kapitalit te shoqerise.

Megjithkete ,pas heqjes se shumave per t'u kaluar ne rezerve ne zbatim te ligjit, asambleja e pergjithshme, mund te heqe cdo shume qe ajo e gjykon te pershtatshme per te krijuar rezerva te zakonshme ose te jashtezakonshme ose per ta mbartur shumen ne ushtrimin e ardhshem.

Fitimi I mbetur shperndahet ndermjet aksionereve ne perputhje me numrin e aksioneve qe I perkasin secilit ose shperndahet ne baze te vendimeve te asamblese se aksionereve per shperndarjen e divedenteve apo zerave te tjere.

**Neni 28**
**Likuidimi/ Mbyllja**

Perjashtuar rastin e nje prishje me vendim gjyqi te parashikuar nga ligji shoqeria mund te prishet me mbarim te afatit te caktuar me statut ose me vendim te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve.

Pervec rastit te bashkimit ose te ndarjes prishja e shoqerise per cfardo shkaku qofte sjell likujdimin e saj. Likujdimi kryhet nga nje ose disa likujdatore te emeruar nga asambleja e pergjithshme e zakonshme ose nga asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme ne kushtet e quorumit dhe te shumices per asamblete e zakonshme.

Likjdatori perfaqson shoqerine. Ai ka kompetenca te plota per te shitur aktivet e shoqerise, per te shlyer kreditoret dhe per te shperndare mbetjen e disponueshme.

Asambleja pergjithshme e aksionereve mund te autorizoje likujdatorin te vazhdoje ceshtjet ne proces ose te ndermarre ceshtje te reja per nevojat e likujdimit.

Aktivi neto I mbetur, pas shlyerjes te vlerse nominale te aksioneve ndahet midis aksionerve ne perpjestim me pjesmarrjen e tyre ne kapital.

**Neni 29**
**Publikimet**

Me qellim qe te kryhen publikimet lidhur me themelimin e shoqerise te gjitha kompetencat I jepen Z. Mirel Mertiri, I cili eshte dhe Drejtor I kesaj shoqerie., I cili ka te drejte te :

-firmos dhe ben te publikohet njoftimi I themelimit ne nje gazete te autorizuar per njoftimet ligjore.

-kryen te gjitha formalitetet per rregjistrimin e shoqerise ne rregjistrin tregtar

-dhe pergjithsisht per te kryer te gjitha formalitetet e kerkuara nga ligji.

## KREU VIII

## DISPOZITA PERFUNDIMTARE

### Neni 30
### Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likujdimit te saj midis shoqerise dhe aksionereve ose midis vete aksionereve,lidhur me veprimtarine e shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejte ndermjet te interesuarve.

Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje ato i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

**AKSIONERET**

**MIREL MERTIRI** Mirel Mertiri

**ERVIN MERTIRI** Ervin Mërtiri

**ERISELDA PACO** Eriselda Paco

**VJOLLCA AJAZAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISE TIRANË
Nr. 907 rep
NR 231 kol.

# VERTETIM

Sot më datën 11.05.2004 ( Dymijëekater), para meje Noteres Fatbardha Kore, e regjistruar në Dhomën e Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht **1. Mirel Mertiri**, i biri i Trifonit i datelindjes 08.08. 1978 ne Fier dhe banues ne Fier ne lagjen "8 Shkurti", rr. "Thoma Kopace", nr. 25, shtetas shqiptar me numër pasaporte Z 0885654 ; **2. Ervin Mertiri**, i biri i Trifonit , i datelindjes 20.03.1980 lindur ne Fier dhe banues ne Fier ne lagjen "8 Shkurti", Rr. " Thoma Kopace", nr.25; **3. Eriselda Paco** e bija e Thomait, e datelindjes 24. 02.1980 , banuese ne Tirane , Rr. "Elbasanit" , Pall.15, shk.2, ap. 15, me numër pasaporte 1224334, **4. Vjollca Ajazaj** e bija e Ilias, e datelindjes 11.11.1950, banuese në Tiranë, B "Zhan D'Ark", Pall. 20, shk. 1, ap. 18, me numër Z 0779049 te pasaportes se saj personale; të gjithë madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova nga dokumentat identifikuese sa sipër, të cilët nënshkruan në prezencën time këtë statut, pasi deklaruan se e kanë kuptuar mirë përmbajtjen dhe unë noterja e vertetoj rregullisht konform ligjit.

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

NOTERE

FATBARDHA KORE

FATBARDHA KORE
NOTERE
TIRANE ALBANIA
CEL. 0682238020

Vjollca Ajazaj

LENDA: KTHIM PERGJIGJE

DREJTUAR: Z.MIREL MERTIRI

PASI U NJOHA ME NJOFTIMIN TUAJ TE DATES 25.05.2004, E CILA ME VE NE DIJENI PER SHITJEN NGA ANA JUAJ E PAKETES SE AKSIONEVE QE JU ZOTERONI, PAKETE KJO QE PERFAQESON 40 % TE KAPITALIT TE SHOQERISE AKSIONERE "DIGITAL CABLE NETWORK", JU BEJ TE DITUR NUK JAM I INTERESUAR PER BLERJEN E KESAJ PAKETE AKSIONESH.

TIRANE ME 26.08.2004

ME RESPEKT
ERISELDA PACO

LENDA: KTHIM PERGJIGJE

DREJTUAR: Z.MIREL MERTIRI

PASI U NJOHA ME NJOFTIMIN TUAJ TE DATES 25.05.2004, E CILA ME VE NE DIJENI PER SHITJEN NGA ANA JUAJ E PAKETES SE AKSIONEVE QE JU ZOTERONI, PAKETE KJO QE PERFAQESON 40 % TE KAPITALIT TE SHOQERISE AKSIONERE "DIGITAL CABLE NETWORK", JU BEJ TE DITUR NUK JAM I INTERESUAR PER BLERJEN E KESAJ PAKETE AKSIONESH.

TIRANE ME 26.08.2004

ME RESPEKT
ERVIN MERTIRI

# NJOFTIM

## PER SHITJE TE AKSIONEVE

Une I nenshkruari, **Mirel Mertiri**, lindur ne Fier me 08.08.1978, dhe banues ne Tirane, zoteroj 40 % te aksioneve ne shoqerine aksionere "DIGITAL CABLE NETWORK", te krijuar me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr.31614, date 14.05.2004,

Si aksioner I kesaj shoqerie kam vendosur te shes paketen time te aksioneve, te cilat perbejne 40 % te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Duke u mbeshtetur ne ligjet ne fuqi, dhe ne menyre te vecante ne ligjin "Per shoqerite tregetare", njoftoj paraprakisht per shitjen e ketyre aksioneve, me vlere 400 000 leke, aksioneret e tjere te kesaj shoqerie:

1. Ervin Mertiri
2. Eriselda Paco
3. Vjollca Ajazaj

Ne rast se jeni te interesuar per blerjen e ketyre aksioneve ju lutem te me njofoni me shkrim brenda dates 25.08.2004.

Tirane me 25.05.2004

Me respekt

Mirel Mertiri

LENDA: KTHIM PERGJIGJE

DREJTUAR: Z.MIREL MERTIRI

PASI U NJOHA ME NJOFTIMIN TUAJ TE DATES 25.05.2004, E CILA ME VE NE DIJENI PER SHITJEN NGA ANA JUAJ E PAKETES SE AKSIONEVE QE JU ZOTERONI, PAKETE KJO QE PERFAQESON 40 % TE KAPITALIT TE SHOQERISE AKSIONERE "DIGITAL CABLE NETWORK", JU BEJ TE DITUR NUK JAM I INTERESUAR PER BLERJEN E KESAJ PAKETE AKSIONESH.

TIRANE ME 26.08.2004

ME RESPEKT
VJOLLCA AJAZAJ

31614/2

# K E R K E S E

KERKUES: MIREL MERTIRI i biri Trifonit i datelindjes 08.08.1978, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, lagja nr.1, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

OBJEKTI: Depozitim I Vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise " Digital Cable Network" sh.a me seli ne Tirane, rr. Elbasanit Pallati I ri perballe disco "Calvin" regjistruar ne regjistrin tregetar me vendim te Gjykates se Tiranes me nr 31614 date 14.05.2004

BAZA LIGJORE: Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare" si dhe Neni 5, 10 dhe 16 i Statutit te Shoqerise.

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Zoti Kryetar,

Ne vendimin nr. 31614 date 14.05.2004 eshte vendosur regjistrimi I shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a, me seli ne Tirane rr. Elbasanit Pallati I ri perballe disco "Calvin".

Sipas vendimit te asamblese se ortakeve nr.2 date 20.01.2005 kerkoj depozitimin e kesaj kerkese per

- Miratimin per shitjen e aksioneve te aksionerit Bledar Gjata ne masen 10 %, zonjes Xhemile Xhindi dhe 10 % zonjes Shpresa Dingo Rrogu sipas Kontratave te Shitjes se aksioneve.
- Pranimin si aksionere te rinj te shoqerise, Zj Xhemile Xhindi dhe Zj. Shpresa Dingo Rrogu.

  Shperndarja e aksioneve ne shoqeri do te jete

- Bledar Gjata ................ 20 % te aksioneve
- Ervin Mertiri ................ 40 % te aksioneve
- Eriselda Paco .................. 15 % te aksioneve
- Vjollca Ajazaj .................. 5% te aksioneve
- Xhemile Xhindi ................ 10% te aksioneve
- Shpresa Dingo Rrogu .............. 10% te aksioneve

1. depozitimin e dokumentave si Vendimi I ortakut te vetem te shoqerise dhe Kontraten e Shitjes se kuotave prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane per miratim.

Per kryerjen e veprimeve te nevojshme caktohet administratori i shoqerise z. MIREL MERTIRI

Prandaj, kerkoj nga kjo Gjykate qe te caktoje nje dite per gjykimin e kerkeses time dhe te vendose per depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a , se bashku me kontraten e shitjes se kuotave

KERKUES

ADMINISTRATOR

MIREL MERTIRI

REPUBLIKA E SHQIPERISE Sh a DIGITAL CABLE NETWORK TIRANE ALBANIA

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE DURIM B. LEKDUSHI NOTER FIER

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE FIER
NOTER DURIM LEKDUSHI
Nr 611 regj.

Fier me 27.01.2005

## VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 27.01.2005 ne Fier para meje noterit Durim Lekdushi me zyre noterie prane Gjykates se Rrethit Fier u paraqit shtetasi shqiptare i mesiperm .I cili eshte madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin e te cilit u sigurova me dokumentat perkatese .i cili ka nenshkruar dokumentin e mesiperm ne prezencen time.

NOTER
DURIM LEKDUSHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE FIER
NOTER DURIM LEKDUSHI
Nr 2127 rep.Nr 1151 kol

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

Fier me 25.12.2004

***KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH***
( Baza ligjore : Neni 705 e vijues i K.Civil )

Ne Fier sot me date 25.12.2004 para meje Noterit Durim Lekdushi ne studion time Noteriale te ndodhur prane gjykates se rrethit Fier u paraqiten personalisht shtetasit shqiptare;

**Shitesi :Bledar Gjata** , i biri i **Ganiut**, lindur me 29.01.1975 ne Fier dhe banues ne Fier. Madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, I panjohur prej meje Noterit per identitetin e te cilit u binda nga patenta me Nr 881608

**Bleres : Shpresa Dingo Rogu e bija e Llarzarit** ,lindur me 29 .11. 1968 ne Berat dhe banues ne Berat. Madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, I identifikuar personalisht nga une noteri me pashaport me Nr 0014442

Une shitesi Bledar Gjata jam aksionere i shoqerise aksionare "DIGITAL CABLE NETWORK" Sh.a shoqeri e krijuar dhe e regjistruar pran Gjykates se shkalles se Pare Tirane me vendim nr 31614 date 14.05.2004 si aksioner i kesaje shoqerie zotroj **40%**te aksioneve te saj pasi kame njoftuar dhe ortaket e tjere dote shese **10%**te aksioneve te mia
**10%**znj Shpresa Dingo Rogu. per shumen (300 000 leke) (trqind mije) leke .
Kete kontrate palet pasi e lexojne e gjejne konforme vullnetit te tyre e miratojne duke e nenshkruar ate ne prezencen time .
Une noteri vertetoj aktin duke e nenshkruar ate .

PALA SHITESE
Bledar Gjata

NOTER
DURIM LEKDUSHI

PALA BLERESE
Shpresa Dingo (Rogu)

PULLE TAKSE
100 LEKE R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE FIER
NOTER DURIM LEKDUSHI
Nr 7128 rep.Nr 1152 kol

Fier me 25.12.2004

***KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH***

( Baza ligjore : Neni 705 e vijues i K.Civil )

Ne Fier sot me date 25.12.2004 para meje Noterit Durim Lekdushi ne studion time Noteriale te ndodhur prane gjykates se rrethit Fier u paraqiten personalisht shtetasit shqiptare;

**Shitesi :Bledar Gjata ,** i biri i **Ganiut**, lindur me 29.01.1975 ne Fier dhe banues ne Fier. Madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, I panjohur prej meje Noterit per identitetin e te cilit u binda nga patenta me Nr 881608

**Bleres : Xhemile Xhindi** e bija **Shabanit** ,lindur me 28.07. 1962 ne Fier dhe banues Fier . Madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, I identifikuar personalisht nga une noteri me pashaport me Nr 0014519

.

Une shitesi Bledar Gjata jam aksionere i shoqerise aksionare "DIGITAL CABLE NETWORK" Sh.a shoqeri e krijuar dhe e regjistruar pran Gjykates se shkalles se Pare Tirane me vendim nr 31614 date 14.05.2004 si aksioner i kesaje shoqerie zotroj **30%**te aksioneve te saj pasi kame njoftuar dhe ortaket e tjere dote shese **10%**te aksioneve te mia
**10%**znj Xhemile Xhindi per shumen 300 000 leke trqind mije leke .
Kete kontrate palet pasi e lexojne e gjejne konforme vullnetit te tyre e miratojne duke e nenshkruar ate ne prezencen time .
Une noteri vertetoj aktin duke e nenshkruar ate .

PALA SHITESE

Bledar Gjata

NOTER
DURIM LEKDUSHI

PALA BLERESE

Xhemile Xhindi

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

NR 31614 REGJ

PULLE TAKSE 100 LEKE

PULLE TAKSE 100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

**VENDIM**

**PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK**

Ne Tirane sot ne date 14. 05. 2004, une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ______, mora ne shqyrtim kerkesen e bere nga Z.Mirel Mertiri, per rregjistrimin si person juridik te shoqerise Anonime pa Oferte Publike "DIGITAL CABLE NETWORK" SH.A dhe:

REPUBLIKA E SHQIPERISE Zyra e Noterise VERTETOHET NJESIA ME ORIGJINALIN 617 Date 27.01.05 NOTER DURIM LEKOCHI

**KONSTATOVA**

Se aksioneret Mirel Mertiri, Ervin Mertiri, Eriselda Paco dhe Vjolla Ajazaj me vullnetin e tyre te lire kane themeluar shoqerine anonime pa oferte publike "DIGITAL CABLE NETWORK" SH.A dhe me objekt te veprimtarise se saj: - Ai perfshin *prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.*

- *Aktiviteti I shoqerise do te plotesohet duke respektuar paanshmerisht te drejten per informacion, bindje politike e besime fetare, personalitetin, dinjitetin , jeten private te njeriut si dhe te drejtat dhe lirite themelore te tij.*

**Kapitali themeltar I** shoqerise eshte 10 000 000 leke (dhjetemilion leke), I ndare ne 1000 (njmije) aksione nominative dhe te rregjistruara me nje vlere nominale prej 10 000 (dhjete mije) lekesh secila. Kapitali I shoqerise formohet nga kontributet e meposhtme:

1. **z. Mirel Mertiri** zoteron 400 (katerqind) aksione me nje vlere prej 4 000 000 (kater milion) lekesh, per aksionet me Nr. 1 deri N.400 qe perfaqeson 40 % te kapitalit te shoqerise
2. **z. Ervin Mertiri** zoteron 400 (katerqind) aksione me nje vlere prej 4 000 000 (kater milion) lekesh, per aksionet me Nr. 400 deri N.800, qe perfaqeson 40 % te kapitalit te shoqerise
3. **Zj Eriselda Paco** zoteron 150 (njeqind e pesedhjete) aksione me nje vlere prej 1 500 000 (nje milion e peseqind mije) lekesh, per aksionet me Nr. 800 deri N. 950, qe perfaqeson 15 % te kapitalit te shoqerise.
4 **Zj Vjollca Ajazaj** , zoteron 50 (pesedhjete) aksione me nje vlere prej 500 000 (peseqind mije) lekesh, per aksionet me Nr. 950 deri N. 1000, qe perfaqeson 5 % te kapitalit te shoqerise.

**Selia e shoqerise** do te jete ne Tirane, Rr. "Elbasanit" Pall. I ri perballe disko "Calvin", kati I pare.

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete e pakufizuar.

- Drejtor I shoqerise do te jete Z. **Mirel Mertiri**.
- Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane emeruar **Naim Kacorri** , **Pajtim Ajazaj** dhe **Artan Qamili**

**Forma e Shoqerise:** Ajo do te krijohet si nje shoqeri anonime pa oferte publike.
Persa me siper kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj

**PER KETO ARSYE:**

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregetare" dhe ligjit nr. 7667 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar" dhe ligjit nr. 8410 date 30.09.1998 "Per Radio Televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise"

**VENDOSA**

Regjistrimin si person Juridik te Shoqerise Anonime pa oferte publike "**DIGITAL CABLE NETWORK" SH.A** me aksionere **Mirel Mertiri, Ervin Mertiri, Eriselda Paco** dhe **Vjolla Ajazaj** dhe me objekt te veprimtarise se saj: - *Ai perfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.*

- *Aktiviteti I shoqerise do te plotesohet duke respektuar paanshmerisht te drejten per informacion, bindje politike e besime fetare, personalitetin, dinjitetin , jeten private te njeriut si dhe te drejtat dhe lirite themelore te tij.*

**Kapitali themeltar I** shoqerise eshte 10 000 000 leke (dhjetemilion leke), I ndare ne 1000 (njmije) aksione nominative dhe te rregjistruara me nje vlere nominale prej 10 000 (dhjete mije) lekesh secila. Kapitali I shoqerise formohet nga kontributet e meposhtme:

1. **z. Mirel Mertiri** zoteron 400 (katerqind) aksione me nje vlere prej 4 000 000 (kater milion) lekesh, per aksionet me Nr. 1 deri N.400 qe perfaqeson 40 % te kapitalit te shoqerise
2. **z. Ervin Mertiri** zoteron 400 (katerqind) aksione me nje vlere prej 4 000 000 (kater milion) lekesh, per aksionet me Nr. 400 deri N.800, qe perfaqeson 40 % te kapitalit te shoqerise
3. **Zj Eriselda Paco** zoteron 150 (njeqind e pesedhjete) aksione me nje vlere prej 1 500 000 (nje milion e peseqind mije) lekesh, per aksionet me Nr. 800 deri N. 950, qe perfaqeson 15 % te kapitalit te shoqerise.
4 **Zj Vjollca Ajazaj** , zoteron 50 (pesedhjete) aksione me nje vlere prej 500 000 (peseqind mije) lekesh, per aksionet me Nr. 950 deri N. 1000, qe perfaqeson 5 % te kapitalit te shoqerise.

**Selia e shoqerise** do te jete ne Tirane, Rr. "Elbasanit" Pall. I ri perballe disko "Calvin", kati I pare.
Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete e pakufizuar.

- Drejtor I shoqerise do te jete Z. **Mirel Mertiri.**
- Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane emeruar **Naim Kacorri** , **Pajtim Ajazaj** dhe **Artan Qamili**

**Forma e Shoqerise:** Ajo do te krijohet si nje shoqeri anonime pa oferte publike.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJYKATA E SHKALLES SE PARE - TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA AKSIONERE
" DIGITAL CABLE NETWRK" sh.a TIRANE

**VENDIM I ASAMBLESE SE AKSIONEREVE**

Nr.2 DATE 20.01.2005

Ne Tirane , sot me daten 20.01.2005 Asambleja e Aksionereve te Shoqerise "DIGITAL CABLE NETWRK " sh.a . me pjesemarrjen e aksionereve BLEDAR GJATA, ERVIN MERTIRI, ERISELDA PACO, VJOLLCA AJAZAJ, shqyrtoi:

RENDIN E DITES

- Miratimin per shitjen e aksioneve te aksionerit Bledar Gjata ne masen 10 % , zonjes Shpresa Dingo Rogu, dhe 10 % zonjes Xhemile Xhindi nga perqindja qe zoteron Z Bledar Gjata ne shoqeri, sipas Kontratave te Shitjes se aksioneve.
- Pranimin si aksionere te rinj te shoqerise, Zj. Shpresa Dingo Rogu dhe Zj Xhemile Xhindi
- Depozitimin e dokumetave si Vendimi I Asamblese se Ortakeve dhe Kontratat e Shitjes prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane per miratim.

Mbledhja mbahet ne prani te aksionereve.

- Bledar Gjata ................ 40 % te aksioneve
- Ervin Mertiri ................ 40 % te aksioneve
- Eriselda Paco ................ 15 % te aksioneve
- Vjollca Ajazaj ................ 5% te aksioneve

Asambleja e Ortakeve me Vendim te Ortakeve duke u mbeshtetur ne ligjin " Per Shoqerite Tregetare",dhe ne nenin 7 te statutit te shoqerise unanimisht :

<u>VENDOSI</u>

- Miratimin per shitjen e aksioneve te aksionerit Bledar Gjata ne masen 10 % , zonjes Shpresa Dingo Rogu dhe 10 % zonjes Xhemile Xhindi sipas Kontratave te Shitjes se aksioneve.
- Pranimin si aksionere te reja te shoqerise, Zj. Shpresa Dingo Rogu dhe Zj. Xhemile Xhindi

Shperndarja e aksioneve ne shoqeri do te jete

- Bledar Gjata ................ 20 % te aksioneve
- Ervin Mertiri ................ 40 % te aksioneve
- Eriselda Paco ................ 15 % te aksioneve
- Vjollca Ajazaj ................ 5% te aksioneve
- Shpresa Dingo Rogu ................ 10 % te aksioneve
- Xhemile Xhindi ................ 10 % te aksioneve

- Per depozitimin e dokumetave si Vendimi i Asamblese se Ortakeve dhe Kontratave te Shitjes prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane caktohet administratori i shoqerise Z. MIREL MERTIRI.

ORTAKET

| BLEDAR GJATA | ERVIN MERTIRI | VJOLLCA AJAZAJ | ERISELDA PACO |
|---|---|---|---|
| Bledar Gjata | | | |

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE FIER
NOTER DURIM LEKDUSHI
Nr 610 regj.

Fier me 27.01.2005

## VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 27.01.2005 ne Fier para meje noterit Durim Lekdushi me zyre noterie prane Gjykates se Rrethit Fier u paraqiten shtetasit shqiptare te mesiperm .te cilet jane madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar . per identitetin e te cileve u sigurova me dokumentat perkatese .te cilet kane nenshkruar dokumentin e mesiperm ne prezencen time.

NOTER
DURIM LEKDUSHI

3 1 6 1 4 13 KERKESE

3 Emaelo Bajo 13 07 2005

13 KORIK 2005

13

**KERKUES**: **MIREL MERTIRI** I biri Trifonit i datelindjes 08.08.1978, banues ne Tirane , Rr. Elbasanit , Pall.prane disko "CALVIN" ; madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**OBJEKTI**: Depozitim I Vendimit te Asamblese se Aksionereve te shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a. me seli ne Tirane, Rr " Elbasanit" pall. I ri perballe disco " Calvin", kati I, rregjistruar ne rregjistrin tregetar me Vendim te Gjykate nr. 31614 date 14.05.2004

**BAZA LIGJORE**: Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare"

**PERPARA**

**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

**TIRANE**

Zoti Kryetar,

Ne vendimin nr. 31614 date 14.05.2004 eshte vendosur rregjistrimi I shoqerise aksionere "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a. Asambleja e kesaj shoqerie me vendimin nr.4 date 07.07.2005 vendosi: 1. Miratimin e largimit nga shoqeria te aksionerit Eriselda Paco , i cili zoteron 15 % te aksioneve te kapitalit themeltar. 2. Miratimin e shitjes se aksioneve nga zj. Eriselda Paco tek Z. Bledar Gjata ne masen 100 % te aksioneve te saj , te cilat perbejne 15 % te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 1.200.000 leke 3. Miratimin per depozitimin e vendimit te asamblese te aksionereve , kontrates se shitjes se aksioneve dhe dokumentave te tjera te nevojshme prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, detyre me te cilen ngarkohet drejtori i shoqerise Z.Mirel Mertiri.
Prandaj i kerkoj kesaj Gjykate qe te caktoje nje dite per gjykimin e kerkeses time dhe te vendose per depozitimin e Vendimit te Asamblese se aksionereve te shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a. se bashku me kontraten e shitjes se aksioneve.

**KERKUES**

**DREJTORI**
**I SHOQERISE ANONIME**
**"DIGITAL CABLE NETWORK" SH.A**

**MIREL MERTIRI**

Merti

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA ANONIME "DIGITAL CABLE NETWORK"sh.a**
**TIRANE**

**VENDIM I ASAMBLESE SE AKSIONEREVE**

Nr. 4 DATE 07.07.2005

Ne Tirane , sot me daten 07.07.2005 Asambleja e Aksionereve te shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK " sh. a . me pjesemarrjen e aksionereve 1. Ervin Mertiri qe zoteron 40 % te kapitalit themeltar te shoqerise 2. Eriselda Paco qe zoteron 15 % te kapitalit themeltar 3. Bledar Gjata i cili zoteron 20 % te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise 4. Vjollca Ajazaj e cila zoteron 5 % te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise 5. Shpresa Dingo (Rogu) e cila zoteron 10 % te aksioneve te shoqerise dhe 6. Xhemile Xhindi e cila zoteron 10 % te aksioneve te shoqerise shqyrtoi:,

**RENDIN E DITES**

1. Miratimin e largimit nga shoqeria te aksionerit Eriselda Paco , i cili zoteron 15 % te aksioneve te kapitalit themeltar.
2. Miratimin e shitjes se aksioneve nga zj. Eriselda Paco tek Z. Bledar Gjata ne masen 100 % te aksioneve te saj , te cilat perbejne 15 % te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 1.200.000 leke
3. Miratimin per depozitimin e vendimit te asamblese te aksionereve , kontrates se shitjes se aksioneve dhe dokumentave te tjera te nevojshme prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, detyre me te cilen ngarkohet drejtori i shoqerise Z.Mirel Mertiri.

Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne statutin e shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a. , Asambleja e aksionereve shqyrtoi rendin e dites dhe ne perfundim te mbledhjes Asambleja unanimisht:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e largimit nga shoqeria te aksionerit Eriselda Paco , i cili zoteron 15 % te aksioneve te kapitalit themeltar.

2. Miratimin e shitjes se aksioneve nga zj. Eriselda Paco tek Z. Bledar Gjata ne masen 100 % te aksioneve te saj , te cilat perbejne 15 % te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 1.200.000 leke
3. Miratimin per depozitimin e vendimit te asamblese te aksionereve , kontrates se shitjes se aksioneve dhe dokumentave te tjera te nevojshme prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, detyre me te cilen ngarkohet drejtori i shoqerise Z.Mirel Mertiri.

Tirane me 07.07 2005

AKSIONERET

| | | |
|---|---|---|
| Ervin MERTIRI | Bledar GJATA | Eriselda PACO |
| Ervin Mërtiri | | |
| Vjollca Ajazaj | Shpresa Dingo (Rogu) | Xhemile Xhindi |
| Vjollca Ajazaj | Shpresa Dingo (Rogu) | Xhemile Xhindi |

PULLE TAKSE
100 LEKE
R. SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE FIER
NOTER DURIM LEKDUSHI
Nr 4394 regj.

Fier me 08.07.2005

**VERTETIM NENSHKRIMI**

Sot me date 08.07.2005 ne Fier para meje noterit Durim Lekdushi me zyre noterie prane Gjykates se Rrethit Fier u paraqiten shtetasit shqiptar te mesiperm ,te cilet jane madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin e te cileve u sigurova me dokumentat perkatese , te cilet kane nenshkruar kontraten e mesiperm ne prezencen time.

NOTER
DURIM LEKDUSHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE FIER
NOTER DURIM LEKDUSHI
NR. 4395 Rep
NR. 810 Kol

PULLE TAKSE

100 LEKE

R. SHQIPERISE

NOTER FIER

**KONTRATE SHITJE - AKSIONESH**

Sot me date 08.07.2005 ( Dy mije e pese) para meje Noterit Durim Lekdushi ne studjon time te ndodhur prane gjykates se rrethit Fier , u paraqiten personalisht palet dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje aksionesh.

**SHITESI:** Eriselda Paco e bija e Thomait , lindur 24.02.1980 ne Fier dhe banuese ne Fier, me nr pasaporte 1224334, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar (ne vijim I referuar si "shitesi" )

**BLERESI:** Bledar Gjata, I biri I Ganiut, lindur ne Fier me 29.01.1975, banues ne Fier me nr pasaporte 1501812, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar ,( ne vijim I referuar si "Bleresi")

**BAZA LIGJORE:** Baza ligjore e kesaj kontrate eshte legjislacioni shqiptar, perkatesisht ligji " Per shoqerite Tregetare" nr. 7638 date 19.11.1992 neni 198 e ne vijim; ne baze te statutit te shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a , shoqeri e cila eshte krijuar me vendim nr. 31614 date 15.05.2004 te Gjykates se Shkalles se Pare - Tirane dhe vendimit nr.4 date 07.07.2005 te Asamblese te Aksionereve te kesaj shoqerie e cila I eshte bashkangjitur kontrates;

**OBJEKTI I KONTRATES:** Objekt I kesaj kontrate shitjeje , eshte shitja e aksioneve dhe e te drejtave te lidhura me to, ne masen e percaktuar me poshte, nga ana e shitesit tek bleresi.

Ne baze te kesaj kontrate shitjeje, shitesja Eriselda Paco, e cila si aksionere e kesaj shoqerie zoteron 15 % te aksioneve ne kapitalit themeltar te saj I shet bleresit Bledar Gjata 100 % te aksioneve qe ajo zoteron ne kete shoqeri, te cilat perbejne 15 % te aksioneve te kapitalit te shoqerise me vleren 1. 200 000 (nje milion e dyqindmije) leke.

NOTER FIER

Edhe bleresi Bledar Gjata eshte dakort dhe pranon blerjen e aksioneve ne vleren e siper cituar , I cili pas blerjes se ketyre aksioneve zoteron 35% te aksioneve te kapitalit themeltar te Shoqerise "DIGITAL CABLE NETWORK" sh.a.

- Me nenshkrimin e kesaj kontrate pala shitese humbet cdo te drejte pronesie mbi aksionet e saj ne kapitalin themeltar , te cilat jane transferuar lirisht nga shitesi tek bleresi, te drejta te cilat I kalojne bleresit.
- Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitjeje , bleresi I paguan shitesit ne total cmimin e kontrates prej 1 200 000 (njemilion e dyqindmije) leke, me pagese te menjehershme , e cila eshte kryer jashte kesaj zyre noterie.

Kontata u perpilua ne kater kopje me vlere te njejte ligjore, iu u lexua paleve kontrktuese me ze te larte , u kuptua prej tyre dhe meqenese shpreh vullnetin e tyre te lire e te plote u nenshkrua rregullisht prej tyre para meje dhe une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

**Shitesi**

Eriselda Paco

Eriselda Paco

**Bleresi**

Bledar Gjata

Bledar Gjata

NOTERI

Durim Lekdushi